




KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Bazuar në Nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryeshefi Ekzekutiv në K.R.U.“Hidroregjioni Jugor” SH. A në Prizren, me datë 12.06.2026 merr këtë:

V E N D I M

Anulohet Konkursi i Jashtëm Nr.2703 të datës 05.05.2026 i publikuar në web faqen e Kompanisë dhe rrjete sociale për plotësimin e vendit të punës për pozitën e punës Drejtor i Departamentit Komercial në K.R.U.“Hidroregjioni Jugor” SH. A. Prizren.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të ecures së procedurës së rekrutimit për pozitën e punës Drejtor i Departamentit Komercial në K.R.U.“Hidroregjioni Jugor” SH. A. Prizren, është vlerësuar se për të garantuar zbatimin e plotë të parimeve të transparencës, objektivitetit, barazisë së trajtimit dhe besimit të publikut në procesin e rekrutimit, është në interes të institucionit që procedura e konkursit të anulohet dhe të rishpallet.

Gjatë zhvillimit të konkursit janë paraqitur rrethana të cilat mund të ndikojnë në perceptimin e transparencës dhe besueshmërisë së procesit nga kandidatët dhe publiku. Për të siguruar një proces të hapur, konkurrues dhe plotësisht të besueshëm për të gjitha palët e interesuara, është vlerësuar se anulimi dhe rishpallja e konkursit paraqet masën më të përshtatshme dhe në përputhje me interesin publik.

Vendimi të i dorëzohet :

- Njësisë së Burimeve Njerëzore,
- Anëtarëve të Komisionit vlerësues, dhe,
- Arkivit.

K.R.U.“Hidroregjioni Jugor” Sh.A


Bekim Gashi
Kryeshef Ekzekutiv

